

VENDIM
Nr. 3, datë 15.1.2021

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST SHA PËR SHTYRJEN E AFATIT TË MARRJES NË SHQYRTIM TË KËRKESËS, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 169, DATË 3.11.2020, “PËR SHQYRTIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE ATË TË PËRDITËSUAR, DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gjerat: “a” dhe “e”, nenit 60, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 43/, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 3 dhe të neneve 91 dhe 92, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 6, 7, 8, 10, 11 dhe 12, të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr.135, datë 6.9.2017, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 7/2 prot., datë 13.1.2021, të Drejtorive Teknike, mbi kërkesën e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) për zgjatjen e afatit për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 216, datë 15.12.2020, vendosi shtyrjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria OST sh.a. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

- OST sh.a., me shkresën drejtuar në ERE nr. 165 prot., datë 11.1.2020, parashtroi se:

Përmes shkresës me nr. 6967/2 prot., datë 21.12.2020, është vënë në dispozicion informacioni shtesë i kërkuar për rishikimin e vendimit nr. 169, datë 3.11.2020, përkatësisht “Draftmetodologjia e vlerësimit kosto – përfitim të projekteve të rrjetit shqiptar të transmetimit”, ku theksohet që ky material është hartuar nga grupi i punës, i ngritur për këtë qëllim, dhe mbetet i tillë, në pritje të finalizimit pasi të jenë reflektuar dhe elementë të tjerë që mund të dalin nga studimi i masterplanit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

- Procesi i hartimit të masterplanit të OST sh.a., “Plani mbi investimet dhe zhvillimin e rrjetit për sektorin e transmetimit të energjisë në Shqipëri për vitet 2018–2033” ka hyrë në fazën përfundimtare dhe sipas skedulit të fundit të miratuar pritet që drafti final i masterplanit të disponohet në fund të dhjetorit.

- Gjatë vitit 2020, afati i përfundimit të masterplanit është shtyrë dy herë për shkak të kufizimeve të krijuara për shkak të pandemisë COVID-19.

- Në respekt të përcaktimeve ligjore, masterplani do të hyjë në fuqi pasi ai të miratohet edhe nga ERE. Për këtë arsye, nëse gjithçka shkon sipas parashikimeve të afateve, OST-ja do të dërgojë për miratim në ERE draftin final të masterplanit për miratim brenda muajit janar.

- Një nga risitë e masterplanit është edhe metodologjia e zhvillimit të tij, e cila është zbatuar në studim. Ky trajtim merr në konsideratë të gjithë paketën e investimeve ekzistuese, si dhe zgjerimin, të cilit i përket projektet e reja që dalin si rezultat i analizës së rrjetit në projeksion për të ardhmen.

- Duke qenë se momentalisht jemi në një fazë shumë të ngjeshur, në të cilin kërkohet një integrim dhe përqendrim i burimeve, përshtatje e metodologjive dhe respektim të afateve të paracaktuara, për të gjitha zhvillimet aktuale dhe në të ardhmen të rrjetit të transmetimit, parashtrohet kërkesa për shtyrje.

- Për të analizuar të gjitha elementet e nevojshme, në mënyrë që të jepet një gjykim dhe argumentim i drejtë, i saktë dhe shterues i kërkesës së parashtruar nga OST sh.a., për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, OST sh.a. duhet të paraqesë të gjithë informacionin e kërkuar nga ERE nëpërmjet komunikimeve zyrtare, me qëllim ezaurimin e procedurës administrative dhe marrjen e një vendimi mbi këtë çështje, si dhe është përcaktuar përkatësisht në nenet 53, pika 3 dhe nenet 91 dhe 92, të “Kodit të Procedurave Administrative”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të marrjes në shqyrtim të kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 169, datë 3.11.2020, “Për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 dhe atë të përditësuar, dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.”, deri në 30 ditë.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti